KOMUNIKATË PËR MEDIA

Misioni këshillues i ekspertëve ndërkombëtarë nga UNFPA & UNECE për Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024)

23 prill 2024

Në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) po qëndron një Mision këshillues i ekspertëve ndërkombëtarë për ta vëzhguar punën e ekipeve të ASK-së për Regjistrimin e Popullsisë (ReKos 2024). Misioni ndërkombëtarë është mbështetur nga UNKT/UNFPA dhe UNECE.

Misioni ndërkombëtarë u prit nga U.d. i Kryeshefit Ekzekutiv të ASK-së, z. Avni Kastrati dhe menaxheri i Regjistrimit të Popullsisë, z. Ylli Shala.

Qëllimi i këtij misioni ndërkombëtar është përveç vëzhgimit të punës së ASK-së edhe të ofrojë mbështetje teknike këshilluese për ASK-në për të ndihmuar që të gjitha proceset e Regjistrimit të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të dhënat e mbledhura të jenë të cilësisë së lartë; të kontribuojnë në dukshmërinë ndërkombëtare dhe kombëtare të përkushtimit të institucioneve të

Kosovës në rundin e regjistrimeve të vitit 2020, si dhe vlerësojë përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare dhe për rrjedhojë të stimulojë transparencën.

Tutje, gjatë gjithë ditës se djeshme u zhvilluan aktivitete me prezantimet e udhëheqësve të ekipeve të Regjistrimit të Popullsisë nga të gjtiha fushat. ASK-ja ka ndarë më herët të gjitha materialet e Regjistrimit të Popullsisë përfshirë edhe pyetësorët dhe dokuemntet e tjera përcjellëse si: planet, starategjitë, legjislacionin, buxhetin etj.

Misioni ndërkombëtarë do të qëndrojë gjatë gjithë javës dhe do të ketë vizita edhe në terren nëpër komuna të ndryshme.